



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi, Nr.8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

e Mërkurë, 29 korrik, 2009

KOMUNIKATË PËR MEDIA

NDËRMARRJA E RE FERRONIKELI SH.P.K, NDËRMARRJA E RE BIRRARIA E PEJËS SH.P.K, DHE NDËRMARRJA E RE IMN SH.P.K LIROHEN NGA MONITORIMI I AKP

Prishtinë- Me datë 29 korrik 2009, në selinë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) në Prishtinë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë mbajti takimin e tij të radhës.

Me propozimin e menaxhmentit të AKP, Bordi i Drejtorëve sot mori vendimin që të liroj nga raportimi i mëtutjeshëm për investime dhe punësim Ndërmarrjen e Re Ferronikeli SH.P.K., Ndërmarrjen e Re BIRRARIA E PEJËS SH.P.K., si dhe Ndërmarrjen e Re Industria e Materialit Ndërtimor (IMN) SH.P.K. Propozimi i menaxhmentit për lirim nga obligimi për raportim të këtyre ndërmarrjeve erdhi si rezultat i përmbushjes së zotimeve për punësim dhe investime nga ana e pronarëve të këtyre ndërmarrjeve.

Në këtë takim të Bordit të Drejtorëve gjithashtu janë aprovuar “Listat Finale” të punëtorëve të pranueshëm për 20% në lidhje me Ndërmarrjet “KHT Kosova,” Prishtinë; “Kosova Hidroteknika”; dhe “Kosova Ndërtimi,” Vushtrri; pas shqyrtimit të të gjitha ankesave nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Punëtorëve pranë AKP-së. Këto Lista do të publikohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe të gjitha ankesat eventuale pas publikimit të tyre mund t’i drejtohen Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës(OVGJSK).

Një vendim tjetër i rëndësishëm i Bordit të Drejtorëve ishte edhe aproviimi i valës së 40 dhe 41 të privatizimit.

Mbledhja e ardhshme e Bordit të Drejtorëve do të mbahet në fund të muajit shtator.

FUND

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Znj. Zana Haxha në zana.haxha@pak-ks.org
apo në 038 500 400 lokali 2006